

STATUTI
I SHOQERISE TREGTARE

“Nom Nom Food & Drinks” Sh.p.k

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Nom Nom Food & Drinks” Sh.p.k, është krijuar sot me date 03.02.2022, nga **Ortaku i vetëm**:

Z. Evisjon Salku, lindur me 23.06.1990, ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar me numer pashaporte **BB8201472**.

Për të bërë të mundur organizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë ekonomike te kësaj Shoqërie, në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe te Ligjit Nr.9723, datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” është përpiluar ky **Statut** si më poshtë:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ortaku i Vetëm, ka krijuar një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar. Shoqëria Tregtare, e fiton të drejtën e personit juridik në momentin e rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 2

Shoqëria Tregtare emërtohet “Nom Nom Food & Drinks” Sh.p.k.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:

Sherbim Bar-Restorant, katering u si dhe cdo veprimtari tjetër ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar.

Neni 4

Shoqëria, në bazë të legjislacionit shqiptar, ka të drejtë të hapë filiale, degë, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si edhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

Neni 5

Selia e shoqërisë tregtare “Nom Nom Food & Drinks” Sh.p.k, është në Tirane, Rruga “Reshit Petrela”, Pallatet Usluga, Kati 0.

Neni 6

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare është për një periudhë te pacaktuar.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare është Leke 1000 (njemije Leke). Ortaku i vetem zotëron 1 kuote ose 100% te Kapitalit Themeltar.

Neni 8

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakut. Pjesët e Kapitalit Themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para ose në natyrë, por jo kontribute në shërbime. Kur pjesët e kapitalit përfaqësojnë kontribute në natyrë, vlerësimi i tyre bëhet nga një ekspert për kontributet nëpërmjet një raporti që i bashkangjitet statutit. Eksperti caktohet nga Ortaku i Vetem.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj.

Neni 9

ZMADHIMI I KAPITALIT

Zmadhimi i Kapitalit, bëhet me vendim të Ortakut te Vetem.

Zmadhimi i kapitalit me anë të nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontribute në para, bëhet sipas paragrafit të fundit, të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008.

Zmadhimi i kapitalit plotësisht ose pjesërisht me anë të kontributeve në natyrë, bëhet sipas kërkesave të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 10

ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Zvogëlimi i Kapitalit, vendoset nga Ortaku i Vetem, i cili merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 11

TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, me rrugë trashëgimie, si edhe ndërmjet paraardhësve e pasardhësve.

Pjesët e Kapitalit Themeltar mund t’u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, në rastin e transferimit me kontrate shitje dhe në të gjitha rastet vetem me miratimin e

Ortakut te Vetem.

Ne rast konflikti, kompetente per zgjidhjen e tij eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane.

KREU III

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 12

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- **Ortakut i Vetëm.**
- **Administratori.**

Administratori emerohet dhe shkarkohet prej Ortakut te Vetem, qe perfaqeson Kapitalin Themeltar.

Perveç kesaj administratori shkarkohet nga gjykata, per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Ortaku mund te marre pjese me mjete te ndryshme komunikimi, ne perputhje me Nenin 88 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 13

Organi me i larte vendimmarres i Shoqërisë eshte **Ortakut i Vetem.**

Ortaku mund t'i delegojë kompetencat e tij personave të zgjedhur.

Vendimet evidentohen në një Regjistër.

Neni 14

Ortaku i Vetem vendos për çështjet e meposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15

Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore redaktohen nga Administratori.

Ortaku i Vetem miraton llogaritë nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Ortaku i Vetem ka të drejte të marrë në çdo moment dokumentat e sipërpërmendura, për 3 vitet e fundit financiarë.

Ai mund të ndihmohet nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit.

Neni 16

Ndrvshimet ne Statutin e Shoqerise, vendosen nga Ortaku i Vetem.

Ne kushtet e mesiperme, Ortaku i Vetem vendos edhe per ceshtje te tjera qe Ligji “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, u referohet shprehimisht.

Ne asnje rast, ortaku nuk mund te detyrohet, te rrise angazhimin e tij ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise.

Neni 17

Administrator i shoqerise eshte zgjedhur Z. Evisjon Salku. Emerimi eshte per nje afat tre vjecar me te drejte rizgjedhje ne perfundim te ketj afati.

Zgjedhja, ndryshimi apo rizgjedhja e Administratorit behet me Vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 18

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer dhe per llogari te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave, qe Ligji apo Statuti, ia jep Ortakut te Vetem.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet lidhur me administrimin e shoqerise.

Administratori ka te drejte te hyje ne marredhenie kontraktore ne emer dhe per llogari te shoqerise ku perfshihen, dhe duke mos u kufizuar vetem ne:

- a) Ndjekja e te gjitha procedurave administrative lidhur me marrjen e licensave per ushtrim aktiviteti, marrjen e lejeve, autorizimeve te nevojshme si dhe cdo dokumenti tjetër te nevojshem, pa kufizim nga organet kompetente, si dhe realizimin e interesave te shoqerise, ne kuader te marredhenieve me organet e pushtetit vendor dhe qendror.
- b) Nenshkrimin e Kontratave Inivduale te Punes si dhe zgjidhjen e tyre.
- c) Nenshkrimin e Kontratave te Siper marrjes, Porosise, te Shkembimit, te Furnizimit, Qirase, Premtim – Shitje, Kontratat e Shitjes etj., ne kuader te permbushjes se objektit te veprimtarise se shoqerise.
- d) Te perfaqesoje shoqerine ne kryerjen e veprimeve bankare me llogarite bankare, qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte, duke pasur te drejte te kryeje cdo veprim me to si terheqje, depozitime, transferta etj.
- e) Si dhe te gjitha veprimet e tjera juridike te shoqerise, te cilat nuk perfshihen ne kompetencat e Ortakut te Vetem.

Administratori, gëzon të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, gjithashtu edhe përpara të gjitha organeve shtetërore, administrative e gjyqësore, të të gjitha instancave.

Personat e trete, qe do te caktohen si perfaqesues te shoqerise nepermjet prokures se posacme te leshuar nga Administratori, do te kene te drejte te veprojne ne emer dhe per llogari te shoqerise, brenda tagreve qe vete administratori gezon, sipas ketij Statuti. Ne te gjitha rastet per cdo tejkalmim te kompetencave nga personi i trete, Administratori do te pergjigjet, kundrejt shoqerise.

Administratori është përgjegjese individualisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë dhe të tregëve për shkelje të Statutit apo fajë të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Neni 19

Për punonjësit që do të punësohen në Shoqëri të Tregtare, do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore, të dala për këtë qëllim, duke lidhur kontratat e punës me secilin. Paga e punës nuk është e kufizuar, por ajo nuk mund të jetë më e ulët se ajo e përcaktuar me vendime të veçanta të qeverisë.

KREU IV

MARRËDHËNIET EKONOMIKO - FINANCIARE

Neni 20

Viti financiar fillon më datën 1 Janar dhe mbaron më datën 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 21

Shoqëria Tregtare, me qëllim që t'i bëjë sa më të lehta dhe më të shpejta pagesat me të tretët, do të hapë llogari bankare në një nga Bankat që janë të njohura nga Shteti Shqiptar, vendase ose të huaja, e cila do të administrohet nga administratoret.

KAPITULLI V

PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 22

Shoqëria priset me vendim të Ortakut të Vetem.

Shoqëria mund të shndërrohet në një nga format e përcaktuara nga ligji, sipas shumicës së kërkuar nga ligji për çdo rast konkret.

Neni 23

Shoqëria Tregtare, hyn në procesin e likuidimit, që në momentin e vendosjes për prishjen e saj. Për fillimin e këtij procesi, Ortaku i Vetem, emëron një likuidues i cili paraqet:

1. raportin e likuidimit,
2. gjendjen e aktivitetit të pasivitetit të Shoqërisë,
3. mënyrën e ndjekjes së operacionit të likuidimit dhe
4. afatin e nevojshëm për përfundimin e tyre.

Në fund të procesit të likuidimit, Ortaku i Vetem, vendos mbi bilancin përfundimtar, mbi aktin dhe rregullsinë e likuidimit, mbi mbylljen e procesit të likuidimit të Shoqërisë.

Neni 24

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin gjatë ekzekutimit të këtij statuti dhe kontratës së themelimit, gjatë ekzistencës së Shoqërisë, si gjatë kryerjes së veprimtarisë, ashtu edhe në procesin e likuidimit, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

ORTAKU

CVISJON | SALKU

A handwritten signature in blue ink, consisting of a vertical line, a horizontal line, and a loop, crossing the vertical line.